



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01Nr.06- 23800 /2025

Datë: 04.08 /2025

*Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VII-të të rregullt për vitin 2025, të mbajtur me datën: 31.07.2025 mori këtë:*

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për transfer të mjeteve buxhetore brenda OB nga kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale Burimi i financimit (21)
2. Nga programi Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nën programi Infrastruktura Rrugore (18018), kodi funksional (0451), nga projekti “Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujerave të zeza në Ranoc, Radulloc, Shtupel, Shtaricë etj”, kodi i projektit 56127, shuma **50,000.00 €**
3. Mjetet buxhetore si në nenin 2 të këtij vendimi transferohen në:
  - 3.1. Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), në projektin “Bashkëfinancim me donatorë”, kodi i projektit 48267, shuma **50,000.00 €**
- **Arsyetim: transferi brenda Organizatës Buxhetore bëhet për harmonizimin e mjeteve për përfundimin e punëve sipas kontratave.**
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunes;**
- **Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi.**

  
**Kryesues i Kuvendit**  
**Fadil Gashi**